



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-040

Prishtinë, më 14 nëntor 2011, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 14 NËNTOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit,

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Gjokiq dhe Duda Balje.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica,

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif Konjufca,

Nga: OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjeve së Kryesisë, të mbajtur më 31 tetor 2011,
2. Përgatitjet për mbledhjet plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 31 tetor 2011

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, mbajtur më 31 tetor 2011, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen e ardhshme plenare

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet të premtën, më 17 nëntor 2011, me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012,
5. Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për mbeturinat,
6. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave

1. Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për mbeturinat

Kryesia e radhiti kërkesën e Komisionit për Bujqësi për mbledhjen plenare më 17 nëntor 2011.

2. Njoftimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri nga data 24-26 tetor 2011

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, të realizuar në Shqipëri nga data 24-26 tetor 2011.

Të ndryshme

1. Kryesia ngarkoi nënkryetarët e Kuvendit: Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti për t'u kujdesur për organizimin e shënimit të 10 - vjetorit të punës së Kuvendit të Kosovës.
2. Kryetari i njoftoi të pranishmit se Kryetari i Parlamentit të Republikës së Kroacisë, zoti Llluka Bebiq do ta vizitojë Kosovën më 23 dhe 24 nëntor dhe do ta mbajë një fjalë rasti para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe mysafirëve të ftuar.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **12:45** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.